

## **L I G J**

**Nr.8553, datë 25.11.1999**

### **PËR POLICINË E SHTETIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **V E N D O S I:**

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Kuptimi

1. Policia e shtetit, në vijim e shprehur "Policia", është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në varësi të Ministrit të Rendit Publik, që ka për mision të mbrojë rendin dhe sigurinë publike, si dhe të garantojë zbatimin e ligjit.
2. Veprimtaria e Policisë bazohet në Kushtetutë, në aktet normative në zbatim të saj, si dhe në aktet ndërkombëtare të pranuar në përputhje me të.
3. Policia ka organizim unik e të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe është e depolitizuar. Ajo është person juridik, buxheti i së cilës është zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik.
4. Policia e realizon misionin e vet duke qenë e pranishme në publik ose edhe forcërisht, në përputhje me statusin e përcaktuar në këtë ligj.
5. Veprimtaria e Policisë është e hapur për publikun, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

Neni 2

## Pandryshueshmëria e statusit

1. Statusi i Policisë, i përcaktuar në këtë ligj, nuk ndryshon edhe në kushtet e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme apo të rasteve të fatkeqësive natyrore.
2. Policia zbaton masat e jashtëzakonshme në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin përkatës.

## Neni 3

### Detyrat institucionale

#### 1. Detyrat institucionale të Policisë janë:

- a) Mbron rendin dhe sigurinë publike.
- b) Mbron ushtrimin e lirive dhe të të drejtave të personit.
- c) Merr masa për parandalimin dhe për zbulimin e krimeve.
- ç) Kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë.
- d) Mbikëqyr qarkullimin rrugor.
- dh) Siguron personalitetet e larta të vendit.
- e) Ruan institucionet dhe pronat më të rëndësishme publike.
- ë) Garanton zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore, që e ngarkojnë atë me detyra.
- f) Ndihmon në rast fatkeqësish natyrore ose aksidentesh.

2. Çdo detyrim, që i caktohet Policisë me akte normative, duhet të jetë në përputhje me detyrat institucionale, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

## Neni 4

### Atributet e Policisë

Ky ligj i jep Policisë atributin për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe atributin e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

Neni 5

Simbolet

Policia ka flamurin dhe stemën e vet, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Forca të tjera policore

1. Për nevoja të veçanta të sigurisë së rendit publik, me kërkesë të motivuar të Ministrit të Rendit Publik dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, në ndihmë të Policisë vihen edhe forca të tjera policore të krijuara me ligj.
2. Çdo forcë tjetër policore e krijuar me ligj, kur ngarkohet me detyra edhe në fushën e rendit e të sigurisë publike, zbaton dispozitat e këtij ligji, si dhe aktet normative të Ministrit të Rendit Publik në këtë fushë.

## **KREU II**

### **AUTORITETET**

Neni 7

Ministri

1. Ministri i Rendit Publik, në vijim i shprehur "Ministri", është drejtuesi më i lartë, i cili brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe programit të Këshillit të Ministrave drejton dhe kontrollon nën përgjegjësinë e tij gjithë veprimtarinë e Policisë dhe ushtron kontrollin civil.
2. Ministri, për kryerjen e funksioneve të tij drejtuese e kontrolluese, nxjerr urdhra, rregullore e udhëzime nëpërmjet të cilave normon veprimtarinë e Policisë në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera normative.

Kontrollin e zbatimit të tyre Ministri e ushtron drejtpërsëdrejti ose me anë të strukturave të Ministrisë së Rendit Publik.

3. Udhëzimet për Policinë, me karakter operues të Ministrit ose të personave të autorizuar prej tij, i komunikohen asaj nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.
4. Ministri përfaqëson Policinë në marrëdhëniet me institucionet e tjera kushtetuese brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet dy ose shumëpalëshe me jashtë.

5. Përgjegjësitë e tjera të Ministrit janë sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në ligje të veçanta.

## Neni 8

### Drejtori i Përgjithshëm i Policisë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, në vijim i shprehur "Drejtori i Përgjithshëm":

a) është drejtuesi më i lartë administrativ dhe teknik për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin brenda Policisë;

b) përfaqëson Policinë në marrëdhëniet me organe të tjera të administratës publike, me organizatat joqeveritare dhe me publikun brenda vendit, ndërsa në marrëdhëniet me jashtë sipas delegimit të Ministrit;

c) nxjerr urdhërshërbimi dhe letërporosi për ushtrimin e funksionit e të përgjegjësive të tij.

2. Drejtori i Përgjithshëm varet nga Ministri dhe merr masa për vënien në zbatim nga Policia të akteve normative të nxjerra prej tij.

3. Organi këshillimor pranë Drejtorit të Përgjithshëm është Shtabi i Policisë, funksionimi dhe përgjegjësitë e të cilit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Policisë.

4. Pranë Drejtorit të Përgjithshëm funksionon "zyra ndihmëse".

## Neni 9

### Emërimi dhe lirimi

1. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e funksionarëve me gradë më të lartë në rolin madhor, në bazë të aftësive dhe të përvojës më të suksesshme profesionale. Këshilli i Ministrave emëron njëri nga kandidaturat e propozuara nga Ministri.

2. Në rastet e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, bashkë me komunikimin e vendimit, Kryeministri i dorëzon atij Flamurin dhe Stemën e Policisë.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë lirohet nga detyra në këto raste:

a) kur jep dorëheqjen;

b) kur bëhet i paaftë nga ana shëndetësore në një periudhë kohe mbi 6 muaj;

c) kur ndaj tij ka filluar ndjekja penale;

ç) kur tregon paaftësi në lidhje me funksionimin dhe rezultatet në drejtimin e Policisë;

d) kur plotëson moshën për pension.

Neni 10

Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm

1. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë, në vijim i shprehur "Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm", është ndihmësi i drejtpërdrejtë i Drejtorit të Përgjithshëm dhe kryen detyrat e deleguara nga ky i fundit.
2. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm kryeson komisionin e gradimeve për rolin e lartë.
3. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm zgjidhet midis funksionarëve të rolit madhor, me aftësi e përvojë profesionale të suksesshme.
4. Emërimi dhe lirimi i tij nga funksioni bëhet në përputhje me nenin 9 të këtij ligji.

### **KREU III**

#### **ORGANIZIMI I POLICISË**

Neni 11

Nivelet e organizimit

Policia organizohet në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme përbën nivelin qendror të Policisë, ndërsa drejtoritë e Policisë së qarkut përbëjnë nivelin vendor të saj.

Neni 12

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është organi më i lartë administrativ dhe teknik brenda Policisë.

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë organizohet në drejtoritë qendrore të:

a) Policisë së Rendit,

- b) Policisë Kriminale,
- c) Policisë Kufitare,
- ç) Policisë Rrugore,
- d) Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe atyre Speciale,

si dhe në struktura të tjera mbështetëse, të personelit, ekonomike, financiare dhe administrative.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka në varësi administrative Institutin e Policisë Shkencore, si dhe struktura të tjera për shërbime specifike.

4. Drejtoritë dhe strukturat mbështetëse qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë janë organet më të larta administrative të juridiksionit lëndor përkatës.

5. Drejtuesit e drejtorive dhe të strukturave mbështetëse qendrore kanë përgjegjësi për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e veprimtarisë në juridiksionin lëndor përkatës.

6. Struktura të veçanta të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë mund të veprojnë edhe drejtpërdrejt në të gjithë territorin e vendit.

## Neni 13

### Drejtoritë e Policisë së qarkut

1. Drejtoritë e Policisë së qarkut janë organet më të larta administrative të Policisë në njësinë vendore të qarkut.

2. Drejtorët e drejtorive të Policisë së qarkut kanë përgjegjësinë për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e veprimtarisë së Policisë brenda juridiksionit territorial dhe janë në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm.

3. Në përbërje të drejtorive të qarkut funksionojnë komisariatet, rajonet, repartet dhe postat e Policisë, të cilat janë njësitë bazë vepruese të Policisë në terren.

4. Struktura të veçanta të drejtorive të Policisë së qarkut veprojnë edhe drejtpërdrejt juridiksionit administrativ përkatës.

## Neni 14

### Përgjegjësitë strukturale

1. Limiti i përgjithshëm i organikës së Policisë vendoset nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit.
2. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, e sektorëve të saj, si dhe limiti i organikës së tyre miratohen nga Ministri.
3. Struktura dhe limiti i organikës së komisariateve, rajoneve, reparteve dhe postave të Policisë miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm, me propozimin e drejtorëve të Policisë së qarkut.

## **KREU IV**

### **RREGULLIMI I PERSONELIT**

#### Neni 15

##### Ndarja e personelit

1. Statusi i punonjësit të Policisë rregullohet me këtë ligj. Në sektorë mbështetës dhe administrativë të Policisë punësohen edhe persona, të cilët trajtohen sipas ligjit "Statusi i nëpunësit civil" apo sipas Kodit të Punës.
2. Sipas detyrave dhe funksioneve që kryejnë në Polici, punonjësit e Policisë kategorizohen në këto role: bazë, të mesme, të larta dhe madhore.
3. Punonjësit e Policisë në rolin bazë kryejnë edhe funksionet e agjentit të Policisë Gjyqësore, ndërsa ata në rolet e mesme dhe të larta kryejnë funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore.
4. Me vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohet njësimi i funksioneve në Polici me funksionet përkatëse në administratën publike.

#### Neni 16

##### Pranimi në Polici

1. Mund të konkurrojnë për punonjës Policie shtetasit shqiptarë pa dallim race, etnie, seksi, bindjeje politike e përkatësie fetare, të cilët plotësojnë këto kushte:
  - a) Kanë zotësinë e plotë për të vepruar.
  - b) Kanë kryer arsimin e mesëm.
  - c) Kanë kryer shërbimin ushtarak (për meshkujt).
  - ç) Kanë sjellje të mirë qytetare.

d) Nuk janë të dënuar penalisht.

dh) Kanë mbushur moshën 19 vjeç, dhe janë nën 30 vjeç.

2. Kushtet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni, janë të zbatueshme edhe për të punësuarit e tjerë, sipas pikës 1 të nenit 15.

3. Për nevojat e sektorëve në Polici, ku kërkohen edhe njohuri të posaçme, mund të pranohen specialistë me arsim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 3 vjet, pasi të kenë kryer më parë kualifikimin përkatës policor dhe të plotësojnë kushtet e pikës 1 të këtij neni, me përjashtim të shkronjës "dh".

## Neni 17

### Betimi

1. Personat e pranuar në Akademinë e Policisë dhe në institutet e Policisë, duhet të bëjnë betimin, sipas rregullores së miratuar dhe të nënshkruajnë kontratën e pranimit, ku përcaktohet detyrimi për të punuar në Polici, jo më pak se 5 vjet menjëherë pas përfundimit të shkollës.

2. Mospranimi për të bërë betimin dhe për të nënshkruar kontratën, sjell largimin e kandidatit nga Policia.

## Neni 18

### Formimi dhe kualifikimi

1. Fituesi i konkursit për punonjës Policie në rolin bazë kryen formimin dhe kualifikimin profesional në institutet e Policisë, ndërsa për rolet e tjera, ky formim kryhet në Akademinë e Policisë.

2. Në përfundim të formimit profesional në institute ose në Akademinë e Policisë, kursanti dhe studenti titullohen përkatësisht "polic dhe "specialist i lartë policie".

3. Akademia e Policisë, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, bën edhe njësimin e diplomave të fituara në shkolla apo kurse kualifikimi policore jashtë shtetit.

4. Shkallët e formimit dhe të kualifikimit profesional, si dhe kohëzgjatja e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Në Akademinë e Policisë, përveç punonjësve të Policisë të rolit bazë, pranohen studentë jashtë Policisë, për rolin e mesëm, sipas një kuote që vendoset nga Ministri i Rendit Publik, por gjithnjë duke plotësuar kërkesat e pikës 1 të nenit 16.

6. Vazhdimi i shkollave të tjera të larta nga punonjësit e Policisë lejohet vetëm me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

## Neni 19

### Emërimi dhe lirimi

1. Emërimi dhe lirimi në detyrë i punonjësit të Policisë i rolit bazë bëhet me urdhër të drejtorit të Policisë së qarkut.
2. Emërimi dhe lirimi në detyrë i punonjësit të Policisë i rolit të mesëm bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.
3. Emërimi dhe lirimi në funksion brenda rolit të lartë bëhet nga Ministri, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.
4. Emërimi dhe lirimi në funksion brenda rolit madhor bëhet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji.
5. Emërimi i punonjësit të Policisë në detyra apo funksione të njëpasnjëshme bëhet me përzgjedhje midis kandidatëve, që kanë vjetërsi më të madhe në gradë dhe vlerësim më të lartë të rezultateve në punë.

## Neni 20

### Largimet dhe përjashtimet

1. Punonjësi i Policisë largohet nga Policia në këto raste:
  - a) kur mbush moshën për pension;
  - b) kur bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj ose me vendim të komisionit mjekësor;
  - c) kur kërkon ai vetë, pasi ka plotësuar kushtet e kontratës së pranimi;
  - ç) kur shkurtohet funksioni organik.
2. Kur punonjësi i Policisë riaftësohet apo kur krijohen funksione të reja organike në Polici, ripranimi bëhet vetëm nga kategoria e të larguarve, duke marrë për bazë formimin, kualifikimin dhe vjetërsinë e shërbimit në Polici para largimit.
3. Punonjësi i Policisë përjashtohet nga Policia në rastet e mëposhtme:

a) kur kryen, në mënyrë të përsëritur, thyerje të rënda të disiplinës dhe nuk i është shuar masa e dhënë më parë;

b) kur nuk paraqitet në detyrë, pa shkaqe të arsyetuara, mbi 7 ditë;

c) kur shkel betimin;

ç) kur është pranuar në kundërshtim me kriteret e vendosura në këtë ligj;

d) kur dënohet penalisht me burgim, me vendim të formës së prerë;

dh) kur humbet zotësinë e plotë për të vepruar.

4. Ankimet për largimin ose përjashtimin nga Policia trajtohen sipas dispozitave të kreut V të këtij ligji.

Neni 21

Rregullorja e personelit

Dispozitat e këtij Kreu, për marrëdhëniet në punë, për ecurinë në karrierë dhe për ndërprerjen e tyre, zbërthehen me hollësi në Rregulloren e Personelit të Policisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

## **KREU V**

### **DISIPLINA**

Neni 22

Gradat

Në Polici funksionon sistemi i gradave hierarkike, rregullimi i të cilave bëhet me ligj të veçantë.

Neni 23

Hierarkia e urdhrit

1. Hierarkia e urdhrit është parimi bazë i disiplinës për punonjësit e Policisë. Urdhri i eprorit me gradë, me detyrë, apo me funksion më të lartë është i detyrueshëm për zbatim nga vartësi, nëse ky urdhër nuk bie ndesh me ligjin.

2. Drejtësia, paanësia, vendosmëria dhe kontrolli për zbatimin e urdhrit, si dhe mbajtja qëndrim për moszbatuesit e urdhrit, janë mjetet kryesore për ruajtjen dhe për forcimin e disiplinës në Polici.
3. Kur urdhri i dhënë është në kundërshtim me ligjin, vartësi duhet t'ia bëjë të ditur eprorit dhe të kërkojë dhënien e tij me shkrim.
4. Kur urdhri haptazi është i paligjshëm, vartësi e kundërshton urdhrin, duke vënë në dijeni personin, që është drejtpërdrejt mbi eprorin e tij.
5. Në rastet kur situata nuk pret për procedurat e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, për pasojat e urdhrit të paligjshëm përgjigjet vetëm personi, që e ka dhënë këtë urdhër.
6. Urdhri i ligjshëm është i detyrueshëm për zbatim edhe në rast se veprimi i urdhëruar paraqet rrezik për jetën e punonjësit të Policisë.
7. Mënyrat e dhënies së urdhrit dhe procedurat përcaktohen në Rregulloren e Disiplinës së Policisë.

#### Neni 24

##### Raportet e disiplinës

1. Të gjithë punonjësit e Policisë janë të barabartë ndaj Rregullores së Disiplinës të Policisë.
2. Nderimi dhe besimi tek eprori është detyrë e vartësve.
3. Respektimi i dinjitetit dhe moscenimi i integritetit të personit është detyrë e eprorëve ndaj vartësve.

#### Neni 25

##### Ruajtja e sekretit

1. Ruajtja e sekretit shtetëtor dhe profesional nga personeli i Policisë është i detyrueshëm.
2. Ruajtja e sekretit është e detyrueshme edhe për personat e larguar apo të përjashtuar nga Policia.

#### Neni 26

## Dinjiteti

1. Ruajtja e dinjitetit të punonjësve të Policisë është e detyrueshme ashtu, si dhe mospajtimi me çdo akt korrupsioni dhe shpërdorimi në detyrë.
2. Paraqitja e jashtme, prezantimi, komunikimi dhe veprimet e punonjësit të Policisë në publik përfaqësojnë autoritetin shtetëror.

## Neni 27

### Veprimi i arsyeshëm

1. Në përmbushjen e detyrave punonjësit e Policisë duhet të tregojnë vendosmërinë e nevojshme për të arritur qëllimin e kërkuar ose të lejuar, por në asnjë rast nuk mund të përdorin më shumë forcë sesa është e arsyeshme.
2. Gjatë përmbushjes së detyrës punonjësit të Policisë nuk i lejohet të kryejë ndaj individëve veprime të pabazuara në ligj, ndëshkime ose trajtime çnjerëzore apo denigruese, si dhe çdo lloj torture.
3. Kur punonjësit të Policisë i është besuar ruajtja e një personi, gjendja shëndetësore e të cilit kërkon përkujdesje mjekësore, ai kërkon ndihmën e personelit mjekësor dhe, në rast nevojë, merr masa për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e këtij personi.

## Neni 28

### Ruajtja e pronës

Punonjësi i Policisë është i detyruar të ruajë dhe të mirëmbajë armatimin, mjediset, teknikën dhe mjetet e dhëna në përdorim për kryerjen e detyrës.

## Neni 29

### Masat disiplinore

1. Punonjësit e Policisë, që shkelin rregullat e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore që lidhen me detyrën ose që nuk zbatojnë urdhrat ose detyrat e shërbimit, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, ndëshkohen me masa disiplinore, si vijon:

a) Vërejtje;

b) vërejtje me paralajmërim;

- c) gjobë në masën e pagës deri 5 ditë pune;
- ç) shtyrjen e afatit të gradimit deri në një vit;
- d) uljen në detyrë ose në funksion;
- dh) pezullimin nga detyra apo nga funksioni deri në 3 muaj ose deri në përfundimin e çështjes penale;
- e) përjashtimin nga Policia, sipas pikës 3 të nenit 20.

2. Masat e mësipërme jepen nga eprori i drejtpërdrejtë ose nga titullari i organit apo repartit, në mënyrë të shkallëzuar ose në bazë të rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave. Dëmi material i shkaktuar çdëmtohet sipas akteve normative përkatëse.

3. Në çdo rast, masa disiplinore i komunikohet drejtpërdrejt punonjësit dhe kur ka interes, mund të bëhet edhe publike.

#### Neni 30

##### Shuarja e masave disiplinore

1. Masa disiplinore "vërejtje" ose "vërejtje me paralajmërim" shuhet me kalimin e 6 muajve nga data e dhënies së saj.
2. Masat e tjera disiplinore, me përjashtim të shkronjës "e" të nenit 29, shuhen me kalimin e 1 viti nga data e dhënies së tyre.
3. Për masat disiplinore të ankimuara, afatet e shuarjes fillojnë nga data që vendimi i titullarit ka marrë formën e prerë.
4. Në raste të veçanta, kur i ndëshkuari kryen akte përkushtimi në detyrë, heqja e masës disiplinore bëhet nga titullari para afateve.
5. Gjatë periudhës në masë disiplinore ndërpritet ecja e afateve, që lidhen me fitimin e të drejtave të parashikuara për punonjësën e Policisë, duke përjashtuar vjetërsinë në shërbim.

#### Neni 31

##### Ankimi

1. Në çdo rast, punonjësit të Policisë, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore, i lind e drejta për të bërë ankim me shkrim te titullari i organit.

2. Kur titullari e gjykon të pabazuar dhënien e masës disiplinore e anulon atë, në të kundërt ai kundërfirmos për lënien në fuqi të masës dhe ia kalon për shqyrtim komisionit disiplinor.

3. E drejta e ankimit humbet në rast se ajo nuk bëhet brenda 10 ditëve nga data e komunikimit të masës disiplinore.

4. Masa disiplinore nuk mund të jepet nga eprori, nëse ajo nuk i komunikohet punonjësit të Policisë, brenda 1 muaji nga vënia re e shkeljes.

## Neni 32

### Komisioni disiplinor

1. Komisionet disiplinore funksionojnë në komisariate, në drejtoritë e Policisë së qarkut dhe në strukturat në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë funksionon Komisioni Qendror i Disiplinës.

2. Pranë çdo komisioni, titullari i organit cakton një oficer disiplinor, i cili përgatit dokumentacionin për mbledhjen e komisionit.

3. Komisionet disiplinore, me përjashtim të Komisionit Qendror të Disiplinës, shqyrtojnë ankesat për masat disiplinore, të dhëna nga eprorët, deri në funksionin e zëvendësit të titullarit të organit, ku ato janë ngritur. Rastet e tjera shqyrtohen nga komisionet eprorë, ndërsa largimet apo përjashtimet shqyrtohen nga Komisioni Qendror i Disiplinës.

4. Komisioni disiplinor, kur e gjen të bazuar, vendos që masa të shënohet në dosjen personale të të ndëshkuarit, me përjashtim të masës "vërejtje". Në të kundërt, i propozon titullarit të organit, për ta rishikuar masën e dhënë. Vendimi i titullarit është i formës së prerë.

5. Kundër vendimit të formës së prerë i ndëshkuari ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve, ndërsa për rastet e pikës "e" të nenit 29, ankimi mund të bëhet edhe drejtpërdrejt në gjykatë.

## Neni 33

### Rregullorja e Disiplinës së Policisë

Dispozitat e këtij kreu përshkruhen me hollësi në "Rregulloren e Disiplinës së Policisë" të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

## **KREU VI**

## **ATRIBUTET PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE TË SIGURISË PUBLIKE**

Neni 34

Paprekshmëria

1. Punonjësi i Policisë në shërbim ose për shkak të shërbimit është i paprekshëm. Fyerjet, kundërshtimet dhe çdo veprim tjetër i dhunshëm ndaj tij dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

2. Kur atij, për shkak të shërbimit, i rrezikohet jeta, familja apo i dëmtohet prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë, kushtet dhe mënyrat e përfitimit të së cilës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35

Uniforma dhe shenjat e Policisë

1. Punonjësi i Policisë i kryen detyrat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike me uniformën dhe shenjat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Uniforma dhe shenjat dalluese të Policisë përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij.

2. Struktura të veçanta të Policisë, të përcaktuara nga Ministri i Rendit Publik, i kryejnë detyrat e tyre me veshje civile ose me modele të përshtatshme uniformash, sipas natyrës së shërbimit.

3. Personeli i Policisë është i pajisur me dokumentin dhe me medalionin zyrtar të identitetit, të cilat i paraqet në çdo rast të kryerjes së detyrës.

4. Në çdo rast të komunikimit me publikun, të ndërhyrjes për stabilizimin e rendit apo për procedime ligjore për kontrollin e personave, të mjediseve, për ndalime ose arrestime, punonjësi i policisë duhet t'i ketë të dukshme shenjat dalluese të Policisë.

Neni 36

Armët dhe pajisjet

Për kryerjen e detyrave të ngarkuara, punonjësit e Policisë pajisen me armatim, me mjete teknike të përshtatshme, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Mbledhja dhe administrimi i informacioneve

1. Punonjësi i Policisë ka të drejtë dhe merr masa për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e informacioneve e të dhënave, për nevoja të ruajtjes së rendit e të sigurisë publike, si dhe për parandalimin dhe zbulimin e krimeve, duke respektuar garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e personit.
2. Ndalohet për çdo rast marrja e informacioneve dhe e të dhënave për persona vetëm për arsye të kombësisë, shtetësisë, racës, fesë, bindjeve politike ose sindikaliste.
3. Organet e administratës publike, të sistemit të drejtësisë, si dhe personat fizikë dhe juridikë, që kanë regjistra e dokumente me të dhëna identifikuese, janë të detyruar t'i paraqesin, kur u kërkohen nga Policia, përjashtuar ato që me ligj klasifikohen konfidenciale.
4. Informacionet e klasifikuara të Policisë, për nevojat e parandalimit e të zbulimit të krimit, grumbullohen, administrohen dhe ruhen, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin përkatës.

Neni 38

Veprimi administrativ

Kur punonjësi i Policisë vëren shkelje administrative, për të cilat ligji ngarkon me detyra Policinë, ai vendos gjobë dhe merr masa të tjera të parashikuara në ligj (procedime, bllokime, sekuestrime etj.)

Neni 39

Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i Policisë bën kontrollin e identitetit të personave në këto raste:
  - a) kur janë të pranishëm në një vendngjarje;
  - b) kur ekzekutohet një urdhër i organeve përkatëse;
  - c) kur bëhet kontrolli i personave të dyshuar për prishje të rendit publik;
  - ç) kur ata hyjnë ose dalin në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i Policisë bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit.
3. Identifikimi është i besueshëm edhe kur punonjësi i Policisë e njeh personalisht personin.

## Neni 40

### Kontrolli fizik

1. Kontrolli fizik i personave, i veshjeve, i bagazheve dhe i automjeteve bëhet nga punonjësi i Policisë, pa një autorizim paraprak të organeve përkatëse, vetëm në rastet e pamundësisë së marrjes së këtij akti dhe kur duhen bërë veprime të ngutshme për:

- a) shmangien e një rreziku të çastit për sigurinë e rendit publik;
- b) parandalimin e një vepre penale nga personat e dyshuar.

2. Kontrolli fizik nuk duhet të cenojë dinjitetin e personit të kontrolluar.

## Neni 41

Për nevoja të sigurisë së rendit publik e të zbatimit të ligjit ose të rasteve të fatkeqësive natyrore apo aksidentale, punonjësit e Policisë blokojnë pjesë të rrugëve, të mjediseve publike ose vende ku ka pjesëmarrje të publikut, deri në kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore.

## Neni 42

### Përparësia

1. Në rast të pamundësisë së përdorimit të mjeteve të shërbimit, për nevoja të ngutshme në kryerjen e detyrës, punonjësi i Policisë mund të vërë në përdorim mjete transporti e ndërlidhjeje të personave fizikë e juridikë, përjashtuar ato të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

2. Në çdo rast të tillë, punonjësi i Policisë, i lëshon një vërtetim personit fizik a juridik që i ka këto mjete, për kompensimin e tyre nga Policia.

## Neni 43

### Hyrja në mjedise

1. Punonjësi i Policisë, në raste të ngutshme, hyn edhe forcërisht në banesë ose në mjedise të tjera, pronë e personave fizikë apo juridikë, pa autorizimin paraprak të organeve përkatëse kur:

- a) ka të dhëna të bazuara se është duke u kryer një krim;
- b) duhet shmangur një rrezik publik i çastit;
- c) duhet të japë ndihmë ose në raste aksidentesh apo fatkeqësish natyrore.

2. Në këto raste, menjëherë pas veprimit, punonjësi i policisë, harton dokumentacionin përkatës dhe njofton personin e interesuar.

3. Hyrja në zyrat ose banesat e përfaqësuesve të Trupit Diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë bëhet vetëm me pëlqimin e tyre.

#### Neni 44

##### Thirrja e personave

Punonjësi i Policisë thërret persona fizikë ose juridikë për t'u paraqitur në zyrat e Policisë, kur për ta ka njoftime për shkelje të ligjit. Thirrja bëhet me anë të fletëthirrjeve ose edhe verbalisht. Nëse personat kundërshtojnë paraqitjen, veprohet në përputhje me nenin 45 të këtij ligji.

#### Neni 45

##### Shoqërimi i personave

1. Punonjësi i Policisë bën shoqërimin e personave në zyrat e Policisë ose organin urdhërdhënës, në kushtet dhe rastet e parashikuara nga neni 27 i Kushtetutës.
2. Personat e shoqëruar, të cilët nuk dyshohen se kanë kryer një vepër penale, trajtohen në kushte të dallueshme nga ndalimi apo arrestimi dhe, në çdo rast shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.
3. Personi i shoqëruar gëzon të gjitha të drejtat e njohura nga neni 28 i Kushtetutës.
4. Për shoqërimin e personave, punonjësi i Policisë bën dokumentimin e veprimit dhe njofton menjëherë eprorin e vet ose organin e interesuar për sqarimin e çështjes.

#### Neni 46

##### Përdorimi i forcës

1. Punonjësi i Policisë përdor forcën dhe mjetet në përdorim, në përputhje me nenin 27, për të parandaluar apo shmangur përdorimin e dhunës nga shkelësit e ligjit, në rastet kur këta të fundit:

- a) nuk pranojnë urdhrat e punonjësve të Policisë, sipas nenit 44;
  - b) përpiqen të lirojnë persona të tjerë, të ndaluar ose të arrestuar nga Policia;
  - c) duke qenë të shoqëruar, të ndaluar ose të arrestuar bëjnë përpjekje për t'u vetëvrarë ose për të rrezikuar jetën e personave të tjerë;
  - ç) bëjnë veprime aktive, qoftë si individë ose në grupe, për cenime të rënda të rendit publik.
2. Përdorimi i forcës, kur e lejojnë rrethanat, duhet të bëhet i paralajmëruar, në mënyrë të përshkallëzuar dhe në raport me dhunën e përdorur nga shkelësit e ligjit. Përdorimi i forcës ndalet menjëherë me ndërprerjen e kundërshtimeve nga shkelësit e ligjit.
3. Në rast lëndimi të personit, ndaj të cilit është përdorur forca, atij i jepet menjëherë ndihma e nevojshme mjekësore.
4. Në rast të veprimeve të paligjshme të individëve ose të grupeve në tubime, punonjësit e Policisë veprojnë në përputhje me ligjin përkatës.

#### Neni 47

##### Përdorimi i armës

Punonjësi i Policisë përdor armën që ka në rastet dhe në kushtet e përcaktuara në ligjin nr.8290, datë 24.2.1998 "Për përdorimin e armëve të zjarrit".

#### Neni 48

##### Rregulloret e veçanta

Procedurat për zbatimin e neneve 37 deri 47 përcaktohen me rregullore të veçanta.

## **KREU VII**

### **DETYRIME TË PUNONJËSVE TË POLICISË**

#### Neni 49

##### Kufizimi i urdhërimit

Punonjësi i Policisë nuk mund të urdhërohet të kryejë detyra që nuk përkojnë me natyrën e shërbimeve të Policisë.

#### Neni 50

Kufizimi për veprimtari të dyta

1. Punonjësi i Policisë nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari private, të cilat e pengojnë në plotësimin e kërkesave të detyrës.
2. Në rastet e dypunësimit, punonjësi i Policisë, paraprakisht, njofton eprorin, i cili bën vlerësimin sipas pikës 1 të këtij neni.

Mosmarrëveshjet zgjidhen nga titullari i organit përkatës.

#### Neni 51

Normat e sjelljes politike

1. Punonjësi i Policisë, në çdo rrethanë, nuk duhet të sillet dhe të mbajë qëndrime, të cilat cenojnë natyrën e depolitizuar të Policisë.
2. Punonjësit të Policisë i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike. Atij i ndalohet, gjithashtu, të bëjë propagandë në favor ose kundër partive a shoqatave politike apo kandidatëve në zgjedhje.
3. E drejta e punonjësit të Policisë për t'u përfaqësuar në organet e zgjedhura rregullohet me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.

#### Neni 52

Kufizimi i së drejtës së grevës

Punonjësve të Policisë u ndalohet të ushtrojnë të drejtën e grevës, si dhe të bëjnë grumbullime me armatimet ose mjetet e shërbimit.

#### Neni 53

Qëndrimi ndaj shërbimit

1. Punonjësit të Policisë i ndalohet në çdo rast të largohet nga shërbimi, veçse me urdhër ose me leje të eprorit përkatës.
2. Punonjësit të Policisë i ndalohet që gjatë shërbimit të kryejë veprime ose sjellje që bien ndesh me përmbushjen e detyrës.
3. Punonjësi i Policisë është i detyruar t'u përgjigjet me korrektësi dhe shpejtësi gjendjeve të gatishmërisë në organin ose në njësinë ku ai shërben.
4. Kur e kërkojnë nevojat e shërbimit, personeli i Policisë është i detyruar të punojë edhe jashtë orarit të punës, kundrejt kompensimit.

#### Neni 54

##### Detyrimet jashtë shërbimit

1. Punonjësi i Policisë edhe jashtë kohës së shërbimit është i detyruar të ndërhyjë në rastet e cenimit të rendit apo të japë ndihmën e nevojshme në rast aksidenti.
2. Kur punonjësi i Policisë është me leje ose me pushime duhet të vërë në dijeni eprorin përkatës për largimin nga vendbanimi.

#### Neni 55

##### Detyrimi për raportim

Kur punonjësi i Policisë vihet në dijeni për shkelje të ligjit, të cilat nuk i ka në përgjegjësi, është i detyruar t'ia raportojë këto shkelje eprorit të vet.

#### Neni 56

##### Juridiksioni penal

Punonjësi i Policisë i nënshtrohet juridiksionit penal të zakonshëm, ndërsa për vepra penale, të kryera në shërbim, përgjigjet sipas dispozitave të veçanta të Kodit Penal.

## **KREU VIII**

### **BASHKËPUNIMI**

#### Neni 57

## Marrëdhëniet me publikun

1. Policia duhet të informojë rregullisht publikun për detyrat që ajo kryen në fushën e mbrojtjes së ushtrimit të plotë të lirive dhe të të drejtave të personave, për rreziqet që mund t'u kanosen nga situatat e cenimit të rendit e të sigurisë publike, të fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste.
2. Policia kërkon ndihmën e publikut për t'u informuar për ngjarjet dhe autorët e veprave penale, duke ofruar shpërblime dhe duke garantuar anonimatin. Kur për këtë shkak personave u rrezikohet jeta, familja ose prona, Policia u siguron atyre mbrojtje të veçantë. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të kësaj mbrojtjeje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Policisë i ndalohet që në njoftimet publike të cenojë dinjitetin e personit, sidomos të të miturve.
4. Policia ofron ndihmën e vet me këshillime, si dhe mbështet nismat e publikut, të shoqatave e të personave të tjerë juridikë, të cilat ndikojnë në përmirësimin e aspekteve të rendit e të sigurisë publike.
5. Në rastet e sipërpërmendura, Policia ka të drejtë të shfrytëzojë mediat publike dhe private, në përputhje me ligjin përkatës.

## Neni 58

### Marrëdhëniet me administratën publike

1. Bashkëpunimi me institucionet e tjera qendrore të administratës publike rregullohet me akte normative të përbashkëta.
2. Në përmbushjen e detyrave Policia mund të bashkëpunojë me të gjitha organizmat e administratës publike, si dhe me persona fizikë e juridikë, duke lidhur marrëveshje ose kontrata me detyrim reciprok.

## Neni 59

### Marrëdhëniet me qeverisjen vendore

1. Organet vendore të Policisë bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore, në fushën e rendit e të sigurisë publike, si dhe në zbatimin e ligjit, duke respektuar pavarësinë e tyre dhe karakterin unitar e të centralizuar të Policisë.
2. Aktet e organeve të qeverisjes vendore janë të detyrueshme për zbatim nga Policia, përderisa ato përputhen me detyrat institucionale të saj, të parashikuara në këtë ligj.

3. Para krijimit ose shpërbërjes së njësive vepruese vendore të Policisë dhe në rastet e emërimit të drejtuesve të Policisë së qarkut apo të shefave të komisariateve, autoriteti përkatës mund të marrë mendimin paraprak të organit të njësive së qeverisjes vendore përkatëse. Në rast mospëlqimi nga organi vendor, autoriteti përkatës bën argumentimin profesional të vendimit të marrë.

4. Drejtorët e Policisë së qarkut dhe shefat e komisariateve paraqesin raport vjetor para organit të zgjedhur të njësive vendore përkatëse për çështjet e rendit e të sigurisë publike, masat e marra dhe detyrat e përcaktuara për përmirësimin e saj, duke respektuar kërkesat e ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror".

5. Kur organi i zgjedhur i qeverisjes vendore krijon organizma, që merren me çështjet e rendit e të sigurisë publike, përfaqësuesi përkatës i strukturës vendore policore duhet të ndihmojë veprimtarinë e këtij organizmi me analiza e studime të kësaj fushe.

Neni 60

Marrëdhëniet me prefektin

Organet e policisë së qarkut mbajnë marrëdhënie me prefektin, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin përkatës.

Neni 61

Marrëdhëniet me jashtë

1. Policia bashkëpunon me policinë e shteteve të tjera ose me organizma ndërkombëtare policore, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe dhe në parimin e reciprocitetit.

2. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, punonjësit e Policisë mund të ushtrojnë autoritetin e dhënë nga ky ligj edhe jashtë vendit, si dhe punonjësit e policive të shteteve të tjera mund të ushtrojnë autoritetin policor përkatës në vendin tonë.

## **KREU IX**

### **TRAJTIMI I PUNONJËSVE TË POLICISË**

Neni 62

Koha e punës dhe e pushimit

1. Koha e punës dhe e pushimit për punonjësit e policisë njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës publike, me përjashtim të përcaktimeve të shprehura në këtë ligj.
2. Pushimi vjetor për punonjësit e policisë është 30 deri në 45 ditë kalendarikë dhe jepet i shkallëzuar, sipas roleve dhe gradave.
3. Kur, për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin janar të vitit pasardhës, në të kundërt bëhen kompensimi në vlerë, sikurse edhe mbikoha e punës dhe e shërbimit.

Punonjësi i policisë i gëzon këto të drejta edhe në rastet e shërbimit në ditët e pushimit javor apo në ditët e festave zyrtare.

4. Në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore apo të gatishmërisë, koha deri në 24 orë mbi kohën normale të punës e të shërbimit, brenda 6 muajve, nuk trajtohet si mbikohë pune.
5. Në rast fatkeqësie familjare, martesë apo në raste të tjera të veçanta, punonjësit të policisë i jepet deri në 7 ditë leje e pagueshme ose deri në 2 muaj leje pa të drejtë pagese.

Periudha e lejes pa të drejtë pagese nuk llogaritet në vjetërsi pune e shërbimi dhe as për efekte të ecurisë në gradë.

6. Kriteret dhe masat e përfitimeve përcaktohen me akt normativ të veçantë.

Neni 63

Rregullimi i pagave

1. Për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë, punonjësi i Policisë ka përparësi në trajtimin me pagë, në raport me punonjësit e tjerë të administratës publike të barazuar me të.
2. Paga e punonjësit të policisë caktohet në varësi të rolit dhe të gradës që ka fituar, të funksionit që kryen, si dhe të kushteve të tjera, të veçanta, të vendit të punës, të shërbimit e të profesionit.
3. Paga mujore e punonjësit të policisë përbëhet nga paga bazë, shtesat mbi pagën bazë (në përqindje ose në shumë absolute) dhe kompensimet për privacionet dhe humbjet që i krijohen punonjësit të policisë, për shkak të nevojave të punës e të shërbimit.
4. Paga bazë mujore është fikse dhe përcaktohet sipas rolit dhe gradës. Punonjësi i policisë përfiton të gjitha shtesat e tjera të veçanta mbi pagë dhe shpërblimet që përfitojnë punonjësit e tjerë të administratës publike.

5. Rregullimi i pagave, kriteret dhe përgjegjësitë për dhënien e tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 64

##### Dhënia e pensionit dhe përfitimet suplementare

1. Punonjësi i policisë, përveç përfitimeve që rrjedhin nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera, suplementare.

2. Përfitimet suplementare për punonjësit e policisë janë:

- a) pagesë për paaftësi të përkohshme dhe të përhershme në punë;
- b) kompensim për dëmtime trupore dhe materiale;
- c) mbulim i shpenzimeve për rehabilitimin shëndetësor;
- ç) trajtim shëndetësor pa pagesë;
- d) përballimi i shpenzimeve të varrimit dhe ndihmat e menjëhershme;
- dh) pension të pjesshëm për vjetërsi shërbimi;
- e) reduktim të moshës së daljes në pension pleqërie;
- ë) shtesë pension pleqërie, invaliditeti e familjar;
- f) trajtim me pagesë kalimtare, për shkak të ndërprerjes ose të pamundësisë së vazhdimit të karrierës;
- g) kompensime e trajtime të tjera, të parashikuara me akte normative të veçanta;

3. E drejta e përfitimeve suplementare për punonjësit e Policisë varet nga koha (vjetërsia) e shërbimit, paga e realizuar dhe kontributi i paguar.

4. Kohë (vjetërsi) shërbimi për punonjësit e Policisë quhet:

- a) koha nga data e pranimit si kursant apo student në polici;
- b) koha e njohur si ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- c) koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të një vendimi të padrejtë;
- ç) koha e qëndrimit në dispozicion, për shkak të pritjes për sistemimin në një funksion në përputhje me gradën;

d) gjysma e periudhës së kaluar si punonjës në sektorët civilë dhe periudha e plotë e kaluar si ushtarak, para pranimit si punonjës policie.

5. Paga e realizuar, për efekt të përfitimit nga ky ligj, është paga bazë mujore, së bashku me shtesat me karakter të përhershëm, që ka përfituar punonjësi i Policisë.

6. Kontributi i paguar është pjesa suplementare e kontributit, mbi atë të përcaktuar në ligjin nr.7703, datë 11.5.1193 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, që paguhet nga shteti dhe nga vetë punonjësi i Policisë.

7. Pensioni i punonjësit të Policisë, masa, kriteret dhe subjektet përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e përfitimeve suplementare, përcaktohen me ligj të veçantë.

## Neni 65

### Përfitime të tjera

Struktura dhe shërbime të veçanta të Policisë trajtohen me veshje dhe me ushqim, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 66

### Përparësia në punësim

Kur punonjësi i policisë bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për të shërbyer në polici ose kur punonjësit të policisë i shkurtohet funksioni organik, ai ka përparësi punësimi në një funksion të barasvlefshëm të administratës publike.

## Neni 67

### Strehimi

1. Policia ndërton, me fonde shtetërore, apartamente banimi, ku mund të strehohen punonjësit e saj, me vjetërsi shërbimi mbi 10 vjet, duke i marrë këto apartamente me qira, me kushte lehtësuese, ose duke i blerë, me kredi të favorshme.

2. Në këto apartamente banimi, me dëshirën e tyre, mund të strehohen, kundrejt blerjes ose qirasë, personalitete të administratës publike ose të drejtësisë, që merren në ruajtje nga policia.

## **KREU X**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 68

1. Trajtimi i punonjësve të policisë deri në plotësimin e akteve normative, të parashikuara në këtë ligj, bëhet sipas statusit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
2. Deri në miratimin e dispozitave të parashikuara në nenin 56 të këtij ligji, punonjësi i policisë, për vepra penale të kryera në shërbim, përgjigjet sipas dispozitave të Kodit Penal Ushtarak të Republikës së Shqipërisë.
3. Deri në krijimin e qarqeve në nivel vendor, funksionet e drejtorive të policisë së qarkut, do t'i kryejnë drejtoritë e policisë së prefekturave.

Neni 69

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore të shprehura në këtë ligj, brenda një viti nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 70

1. Policia e Rendit Publik riorganizohet në përputhje me këtë ligj.
2. Ligji nr.7504, datë 30.7.1991 "Për Policinë e Rendit Publik", si dhe aktet e tjera normative në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e Policisë, por që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 71

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2498, datë 10.12.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**